

NACIONAL

Gazetë javore, letrare & kulturore, e përditshme online

Drejtori: Mujë Buçpapaj
e-mail: bucpapaj@yahoo.com

Mobi: 068 20 74 316

www.gazeta-nacional.com

Adresa: Ish-kinostudio "Shqipëria e re", Tiranë
e-mail: nacionalalbania@yahoo.com

Aromastika e fyejve të Gramshit

Gramshi, një zonë e pasur etnokulturore

NGA Prof. Dr. Ramazan H. Bogdani
(Mjeshtër i Madh)



Talenti i një artisti është dhe mbetet vlerë

Piktori Çaus Vathi ekspozon punet e tij në galerinë e Durrësit

Shkruan: BASHKIM S. KADIU

faqe 21



EDITORIAL

NGA NACIONAL
NË NACIONAL NË
500 NUMRA

Nga Gjekë Marinaj, PhD

Të dashur dashamirës të gazetës Nacional, të nderuar krijues të letërsisë shqipe dhe të huaj, sot kemi në dorë numrin e 500-të të gazetës Nacional. Për më se një dekadë ky thesar i çmuar kombëtar e ka konfirmuar veten jo vetëm si një gazetë e rëndësishme e karakterit letrar-kulturor, por edhe si një fenomen kolatit



Faqe 3

"Krizë Etike", pasqyrë e sjelljes së njeriut

Nga Prof. As. Dr. Ilia S. Larti

Normat etike dhe integriteti janë tregues vlerash themelore, që i paraprijnë njohjes dhe zbatimit të ligjit, perbjnë elementin çelës për funksionimin e një shoqëri demokratike. Sot për sot nuk është aq e lehtë të flitet për funksionimin e një "kornize etike", si bazë



Faqe 22

PARADOKSE TË BOTIMIT ENCIKLOPEDIK TË ASHAK-ut

Mangësi dhe të pavërteta në dy zëra nga Fjalori Enciklopedik i Kosovës

Nga Prof. Dr. RUZHDI USHAKU

Promovimi u bë në "Qendrën Kulturore Nacional", Tiranë



Gazeta "Nacional" dhe Klubi Letrar "Gjon Nikoll Kazazi" Gjakovë, prezantuan veprën poetike të Tahir Bezhanit

ROBERT SHVARC-IT I "FLISTE" EDHE HESHTJA...

Nga Xhahid Bushati

XHANOJA E FILMIT PER FEMIJE, XHANOJA E TE GJITHEVE...

Nga Skifter Këlliçi, Boston, SHBA

NËBRENDËSI

FAQE 8 Në portret nga kujtesa
Poezi nga Vislava Simborska



FAQE 5 Frika nga shtëpia
Poezi nga Robert Frost



FAQE 5 Nata e borës së madhe
Tregim nga Enver Kushi



FAQE 11 Mbi krahët e pranverës
Poezi nga Mustafa Spahiu



FAQE 6-21 Prozë nga:
EVA GJONI OLDA HALILI • AZEM BALIAJ GENTIANA KONE

FAQE 6-21 Poezi nga:
SHEFIK SHKODRA SHPRESA DHIMO ALKETA SHPATA • LUNA COTA NIKOLA VREKA VERA ISTREFAJ

RADIO NACIONAL
93.6Mhz
www.radionacional.al

SIGAL UNIGA GROUP AUSTRIA
BLI ONLINE SIGURACIONIN
www.sigal.com.al

Birra King Pils

Së shpejti në treg romani i ri i shkrimtarit **Flamur Buçpapaj**

DOKTORESHA

Lajthiza
Premium Water

NGA NACIONAL NË NACIONAL NË 500 NUMRA

Nga Gjekë Marinaj, PhD

Të dashur dashamirës të gazetës Nacional, të nderuar krijues të letërsisë shqipe dhe të huaj,

Sot kemi në dorë numrin e 500-të të gazetës Nacional. Për më se një dekadë ky thesar i çmuar kombëtar e ka konfirmuar veten jo vetëm si një gazetë e rëndësishme e karakterit letrar-kulturor, por edhe si një fenomen kultural mbarëkombëtar në shërbim të gjithë njerëzve që kujdesën për gjendjen e botës në të cilën jetojmë.

Ngaqë i njihja mirë peripecitë ndër të cilat kalonte një organ letrar si nga ana financiare ashtu edhe nga parametrat profesional, daljen e numrit të parë të gazetës Nacional në atë kohë e pata perceptuar me tepër si një ëndërr të bukur sesa një realitet. Por falë dashurisë kombëtare, etikës profesionale, sakrificave ekonomike dhe talentit të pakundërshueshëm të poetit dhe gazetarit Mujo Buçpapaj, një mrekulli e tillë u bë dhe mbeti një realitet domethënës publicistik.

Që nga numrat e parë të botimit, Nacional u bë një vektor i rëndësishëm letrar drejt nevojave për kulturë e dije të njeriut shqiptar. U kthye në një vektor universal artistik, koordinatave të cilat u fuqizuan nga të gjithë ne si lexues dhe krijues letrarë në bashkëpunim të ngushtë me botuesin. Sot ngjanë sikur Nacional jeton për të gjithë ne dhe se të gjithë ne jetojmë me Nacional.

Nuk mund të jetë ndryshe kur për mëse një dekadë, Nacional ka mundur të mbajë qëndrim konstruktiv për stabilitet e paqe në rajon dhe botë. Nacional e ka bërë dhe e bën këtë duke kthyer në energji pozitive shpirtin e poezisë, thellësinë e prozës, fuqinë e gazetarisë dhe zjarrin e brendshmen që digjet në bërthamën e tejdukshme të artit.

Kur një esencë lexuesish të zgjuarsis ju, një grup krijuesish të talentuar si të gjithë ne, një botues këmbëngulës e largpamës si Buçpapaj unifikohen me qëllim të mirë, sukcesi bëhet i paevitueshëm. Kut të bashkuar kthehemi në njëforcë shtytëse për ecurinë e kësaj gazete, rezultatet përfundimtare reflektojnë atë që sot celebrim si organi më i besueshëm i këtij lloji në gjuhën shqipe.

Ky rol i rëndësishëm i Nacionalit në jetën tonë është indikativ i nevojës humane për balancimin e vështirësive midis vlerave që duam të mbrojmë dhe atyre që duam fitojmë. Mbështetja jonë e vazhdueshme dhe e gjithanshme e ndihmon gazetën Nacional të vazhdojë rrugën e saj paqësore në përmirësimin gradual të jetës së njerëzimit.

Një mision jo i lehtë për Nacional, duke parë edhe mundësitë e kufizuara për të përballuar këto kohë të vështira për kombin tonë. Ndaj duhet të bëjmë çmos që Nacional të ecin përpara, që të jetë një dukuri instrumentale në zhvillimin dhe avancimin e vlerave tona njerëzore, kulturore, historike, shpirtërore e fetare.

Nacional duhet mbështetur me çdo kusht që të vazhdojë të udhëheq lexuesin me mençuri përmes stuhive politike të vendit dhe botës që po lëkundin kaq fort horizontet. Ka dekada që në Shqipëri secila parti që humb



zgjedhjet mundohet të mobilizojnë popullin në demonstrata që të rrezojnë partinë e ardhur në pushtet. Pozita nuk do opozitë e opozita nuk do pozitë. Të dyja tentojnë ta përdorin popullin si figura shahu për të fituar lojën e tyre.

Është detyra jonë si krijues që nëpërmes gazetës Nacional ta qartësojmë lexuesin se demokracia është shumë më efektive kur jemi konstruktiv, kur tregojmë inteligjencë individuale dhe kolektive në marrjen e vendimeve, kur shpikim ide të mëdha për përmirësimin e të sotmes dhe të ardhmen tonë Kombëtare. Demonstratat janë një opsion i rëndësishëm demokratik por gjithmonë vetëm kur në epiqendër të tyre janë njerëzit e letërsisë, artit dhe kulturës dhe kur ata e konfirmojnë se të gjitha idetë e tjera janë vënë në jetë dhe kanë rezultuar të paefektshme.

Me rritjen e reputacionit si një gazete nacionale në shërbim të plotë të gjithë e njerëzimit, gazetës Nacional i zgjerohet edhe diapazoni i përgjegjësisë kombëtare, përfshi këtu dhe përgjegjësinë e informimit të publikut rreth ngjarjeve që në sipërfaqe dukën jashtë natyrës së saj.

Nëpërmes fuqisë dhe premtimit që rrjedh nga pena dhe mendjet e bashkëpunëtorëve të saj, uroj që Nacional së shpejti të trajtojë edhe pasojat e ndryshimeve klimatike. Sot gazrat jeshile dhe ndotja e ajrit marrin jetë midis shumë klanesh që rezistojnë apo mohojnë rrezikshmërisë serioze që sjellë për ne dhe brezat që vijnë ky fenomen i frikshëm fillimisht industrial e pastaj natyror.

Në anën tjetër të jetës natyrale shqiptare, Nacional gjendet përball një realiteti të çuditshëm ku bëhet fjalë për shkëmbim teritorësh. Le t'i qëndrojmë në krah kësaj gazete, që ta zgjerojë vizionin e saj përfshirës e jo ndarës të njerëzimit, strategjitë e saj për heqje kufijsh e krijim paqe midis kombeve në vend të ndarjeve dhe konflikteve të vazhdueshme me fqinjët dhe botën.

Nacional është ndër gazetën e pakta që mund të vendos ekuilibra paqësor me gjuhë dhe strategji letrare, ngaqë gazetën politike nuk mund ta bëjnë këtë kundrejt fjalorit vulgare divergjencave ekstreme politike me të cilat përballen.

Një nga situatat më alarmante për rolin e Nacionalit si gazetë mbarëkombëtare gjendet jashtë kontureve të imagjinatës kombëtare. Nevoja për ndërgjegjësim dhe edukim ndërkombëtar kundra sëmundjes epidemike të islamofobizmit mbetet çështje e një rëndësie të veçantë. Nacional ka demonstruar disa herë se vlerat tona shpirtërore dhe fetare duhen mbrojtur me penë e jo me armë. Ketë mund ta bëjnë vetëm krijuesit letrar e artistik, mbështetësit e Nacionalit.

Aq më tepër kur sot, feja myslimane duhet të çmohet lart për përpjekjet e vazhdueshme për të sjellë harmoni e paqe për gjithë njerëzimin dhe të vlerësohet për durimin dhe mençurinë që po tregon me patetikët islamofobikë. Në kontrast, Islamizmi po fyhet dhe sfida nga dita në ditë në mungesë të plotë të normave të logjikës dhe kodeve të etikës njerëzore.

Fyhet si fe që gjoja në gjirin e saj rrit apo nxit elemente terroriste. Ky absurditet ndodh në dekadën e dytë të shekullit XXI. Kur të gjithë ne e dimë fare mirë se askush nuk mund të jetë njëherësh edhe mysliman edhe terrorist. Këto dy entitete janë të pakrahueshme midis tyre dhe veprojnë në kahe ekstremisht të kundërta. Myslimanizmi dhe terrorizmi eliminojnë automatikisht njëra-tjetrën. Nëse je mysliman nuk mund të jesh terrorist. Nëse je terrorist nuk mund të jesh mysliman. Aty ku fillon njëra mbaron tjetra.

Në këto rrethana, Nacional ka nevojë për kontributin tonë të gjithanshëm që të vazhdojë të sjellin për në gazetarinë dhe letërsinë që presim prej saj. Ta mbështesim në misionin e saj në kërkim të fakteve vitale, analizave të hollësishme, intervistave interesante dhe

inspirimit suprem artistik dhe kulturor. Duke mbështetur Nacional mbështesim veten si shqiptar dhe krijues.

Nacional na ofron informacione dhe udhëzime të rëndësishme. Ky informacion është vital për ne se ka një përmbajtje që na intereson, që iavlen kohën tonë, që na stimulon mendjen dhe më sfidon talentin. E hapur ndaj të gjithëve pa paragjykim, Nacional është e vetmja gazetë që gjysmën e faqeve të saj në çdo numër ua kushton shqiptarëve që jetojnë jashtë Shqipërisë.

Sidomos për disa nga ne që jetojmë jashtë komuniteteve të mëdha shqiptare, historia, poezia, proza fiktive dhe kritikën letrare që boton çdo javë në Nacional na hapin një shteg të rëndësishëm në udhëtimin tonë drejt përmirësimit të kulturëlinguistikë dhe mbajtjes gjallë të gjuhës letrare shqipe. Kontributi i gazetës në këtë aspekt ndihmon nevojat tona për t'u ekspozuar tek shumë njohuri dhe labirinte akademike që do të ishte e vështirë të gjendeshin diku tjetër.

Kjo pikë është e rëndësishme, sepse niveli akademik është barometri më i saktë i të ardhmes së një vendi. Nacional ka bashkëpunuar me shumë akademikë të shquar shqiptar e të huaj dhe ka potencialin që edhe në të ardhmen të bëhet një burim i besueshëm edukativ dhe frymëzues në këtë pikë. Tani që ka fituar besimin e popullit, uroj që përqendrimi i gazetës të shtohet kundrejt rëndësisë që ka shkollimi i ndershëm akademik. Diplomati pa shkollimin përkatës janë të dëmshme për kombin. Inflacioni akademik është më i rrezikshëm se inflacioni buxhetor i një shteti.

Të gjitha këto janë të mundshme sepse Nacional ka arritur formën e vet të motivimit të krijuesve shqiptarë. Gërshetimi i krijimtarisë së tyre me kompozimet e krijuesve më të mëdhenj botëror ka ndikuar pozitivisht në rritjen e besimit tek gazeta. Nacional i ka nxitur dhe i nxit ata për ta shtyrë veten drejt maksimumit të vlerave që kanë si krijues dhe si modele për brezat e ardhshëm.

Askund tjetër nuk mund shijohen prurjet më të mira të letërsisë bashkëkohore evropiane dhe botërore si në faqet e Nacionalit. Falë bashkëpunimit me një numër të konsiderueshëm tëpërkthyesve që kanë punuar sistematikisht për këtë gazetë ajka e letërsisë botërore është bërë e mundshme për të gjithë.

Si përfundim, unë e vlerësoj shumë gazetën Nacional. Ajo promovon pa paragjykim vlerat unike dhe karakterin letrar të letërsisë shqipe dhe të huaj. Ajo na bashkon, na njeh me njëri-tjetrin, na krijon mundësinë për ta parë veten të reflektuar në dinamikën e krijimtarisë sonë. Nacional dhe na sjellë më afër mënyrës tonë të jetesës si krijues.

Nëse Nacional na duket njerëzore në esencë dhe paraqitje kjo mund ndodh sepse ajo në të vërtetë është më shumë se një gazetë për ne. Nëse dëshirojmë që ajo të ishte një qenie njerëzore që mund ta ftonim në tavolinë dhe ta qerasim me një gotë ujë dhe një kafe kjo ndodh sepse ajo e ka fituar dashurinë tonë pa kushte.

Nëse veprimtaria dhe jetëgjatësia e saj janë të rëndësishme në jetën tonë krijuese dhe argëtuese, atëherë kostoja e një kafeje mund t'i dërgohet fare lehtë botuesit të saj nëpërmes agjencisë Western Union. Krijimtari të mbarë dhe ju faleminderit për vëmendje.